



**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 6, datë 28.12.2020

**PËR  
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR  
BASHKIA SARANDË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 3, DATË 16.10.2017,  
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 3, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Sarandë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 227, datë 26.12.2020, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Sarandë të miratuar me Vendimin Nr. 3, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:

- *Rregullores së Planit:*


- *Kreu III “Rregullat e përdorimit të tokës”, Seksioni II “Aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës”, Shtimi i pikës 4 në nenin 21;*
- *Kreu IV “Rregullat për çdo njësi”, Seksioni I “Rregullat kryesore për çdo sistem territorial”, Shtimi i Nenit 25/1;*
- *Kreu IV “Rregullat për çdo njësi”, Seksioni I “Rregullat kryesore për çdo sistem territorial, Shtimi i pikës 3 në nenin 27;*
- *Kreu IV “Rregullat për çdo njësi”, Seksioni I “Rregullat kryesore për çdo sistem territorial”, Shtimi i nenit 30/1;*
- *Kreu IV “Rregullat për çdo njësi”, Seksioni III “Normat e planifikimit dhe zhvillimit në zonat e banimit”, Shtimi i pikës 3 në nenin 37;*
- *Kreu VI “Rregullat e Sistemit Rrugor, Transportit dhe Hapësirave Publike”, Shtimi i pikës 7 në nenin 63;*
- *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore.*

- *Planit të Zhvillimit:*

- *Harta e Rrjetit Rrugor të propozuar,*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Sarandë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

- LLI
2. Ngarkohen Bashkia Sarandë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
  3. Ngarkohen Bashkia Sarandë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

